



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8112

Tirane, date 15/12/2015

**Drejtuar:** Z.KUJTIM HASA  
SHOQERIA "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" SHA  
FSHATI "BEQIR DARDHA", RRUGA TOMORR SINANI NR.77/4,  
ELBASAN

**Për njoftim:** Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"  
TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR  
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE  
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE  
TIRANE

**Lënda:** Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1450 date 25.01.2010.

**I nderuar z. Hasa,**

Shoqëria "Rruga Asfaltim nr.2, Elbasan" sha është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1450 date 25.01.2010, për gurë gëlqerore ne objektin "Letan", ne Qarkun Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8158 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1450 date 25.01.2010, për gurë gëlqerore ne objektin "Letan", ne Qarkun Elbasan, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2011-2012, vitin 2012-2013, vitin 2013 -2014, vitin 1014 – 2015 dhe vitin 2015 - 2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjuhën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1450 datë 25.01.2010, për gurë gëlqerore në objektin “Letan”, në Qarkun Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1450 datë 25.01.2010, për gurë gëlqerore në objektin “Letan”, në Qarkun Elbasan.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

